

LIGJ
Nr.9636, datë 6.11.2006

PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT
(ndryshuar me ligjet: nr. 49/2013, datë 14.2.2013, nr. 76/2014, datë 10.7.2014, nr. 56/2019, datë 18.7.2019; nr. 92/2024, datë 27.6.2024)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e shëndetit publik nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

- a) përcaktimi i masave për kufizimin e përdorimit të produkteve të duhanit dhe mbrojtjen e publikut nga dëmet nga ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre;
- b) përcaktimi i masave, që krijojnë premisa për ndërgjegjësimin e publikut për dëmet e duhanit dhe garantimin e një informimi efektiv dhe të vazhdueshëm të përdoruesve të produkteve të duhanit për këto dëme;
- c) përcaktimi i masave për të parandaluar fillimin, për të nxitur dhe mbështetur ndërprerjen e përdorimit dhe për të ulur konsumin e prodhimeve të duhanit.

Neni 3
Përkufizime

(ndryshuar pika 12, shtuar fjalë në pikën 13, dhe shtuar pika 18 me ligjin nr. 49/2013, datë 14.2.2013, ndryshuar pikat 1 dhe 7, shtuar fjalë në pikën 18 dhe shtuar pikat 19-36 me ligjin nr. 56/2019, datë 18.7.2019; ndryshuar pika 8 e 10 dhe shtuar pika 37, 38, 39 dhe 40 me ligjin nr. 92/2024, datë 26.7.2024)

Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1. “Produkte duhani” nënkupton produktet që mund të konsumohen dhe të përmbajnë, qoftë dhe pjesërisht, duhan të modifikuar gjenetikisht ose jo.
- 2. “Paketë ose pako” është çdo kuti ose qese e mbyllur, që përmban produkte duhani e që shitet me pakicë.
- 3. “Katran” është kondensimi i thatë e i paholluar, pa nikotinë, i tymit që çlirohet gjatë duhanpirjes.
- 4. “Nikotinë” janë alkaloidet nikotinique helmuese, që gjenden në tymin e duhanit dhe që veprojnë në sistemin nervor.

5. “Monoksidi i karbonit” është një lëndë kimike, që prodhohet gjatë djegies dhe çlirohet me tymin e duhanit.

6. “Tregtim i produkteve të duhanit” janë importi dhe eksporti i produkteve të duhanit, depozitimi për qëllime shitjeje dhe blerjeje.

7. “Pirje duhani” është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo produkti duhani, si dhe e cigares elektronike e shishave/nargjileve.

8. “Reklamim” nënkupton çdo formë të komunikimit tregtar ose jo i tillë, me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të promovimit të një produkti duhani.

9. “Markë” është shenja dalluese, që u vihet produkteve të duhanit për të treguar llojin, cilësinë dhe prodhuesin e tyre, ku përfshihen emrat, shkronjat, numrat, shenjat figurative, kombinimet e ngjyrave apo të nuancave të tyre, si dhe ndërthurja e tyre.

10. “Sponsorizim” nënkupton çdo formë të kontributit publik ose privat për çdo ngjarje, veprimtari ose individ, me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të promovimit të një produkti duhani.

11. “Promovim i duhanit” është çdo lloj veprimtarie, ngjarje apo veprim, që ka për qëllim njohjen e publikut me produkte të reja të duhanit, që janë hedhur apo do të hidhen në treg.

12. “Mjedis publik” është çdo mjedis i hapur për publikun.

13. “Mjedis pune” është çdo hapësirë e mbyllur, ku punonjësit ushtrojnë veprimtarinë dhe detyrat, për të cilat janë punësuar, si dhe salla mbledhjesh, korridore, shkallë, ashensorë, dhoma tualeti dhe çdo mjedis tjetër i mbyllur.

14. “Tavllë duhani/taketuke cigaresh” është një enë e vogël, ku shkundet hiri i produktit të duhanit që po digjet dhe ku lihen bishtat e cigareve.

15. “Masat parandaluese të duhanpirjes” janë veprimtaritë sistematike, që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të popullsisë, duke zgjatur jetën dhe përmirësuar cilësinë e saj.

16. “KNMSHPD” është Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit.

17. “ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardeve)” është një sistem referencash, sipas të cilave vendosen specifikimet dhe kriteret që duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë klasifikimit të materialeve në industri dhe në furnizimin e prodhimeve, testimin dhe analizën, terminologjinë dhe ofrimin e shërbimeve.

18. “Mjedis i mbyllur” është:

a) një mjedis që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar plotësisht me mure dhe çdo lloj materiali tjetër të përhershme ose të përkohshme;

b) një mjedis, që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar me mure të përhershme ose të përkohshme, muret e të cilit kanë hapje të përhershme, që nuk mund të hapen apo të mbyllen, me sipërfaqe më pak se 50 për qind e sipërfaqes së përgjithshme të mureve.

19. ‘Cigare’ nënkupton një mbështjellje duhani të grirë e cila konsumohet nëpërmjet procesit të djegies, përveç purove, cigarillove dhe mbështjelljeve të tjera të duhanit.

20. ‘Duhan kaush/për t’u dredhur’ nënkupton duhanin e grirë në fije të imëta që përdoret për pirje pa përpunim të mëtejshëm industrial.

21. ‘Duhan për llullë’ nënkupton duhanin e grirë trashë për pirje me llullë.

22. ‘Puro’ nënkupton duhanin e grirë, të mbështjellë me gjethe duhani ose me mbështjellëse letre me ngjyrë duhani, me ose pa filtër, që konsumohet nëpërmjet procesit të djegies.

23. ‘Duhan për nargjile (shisha)’ nënkupton duhanin që konsumohet në formë tymi ose avulli, duke kaluar detyrimisht në një enë uji, i cili mund të jetë ose jo i aromatizuar, ose i përzier me sheqer frutash ose melasë.

24. ‘Duhan për t’u nuhatur (burnot)’ nënkupton një produkt duhani pa tymosje, që konsumohet nëpërmjet nuhatjes.

25. 'Duhan për përdorim oral' nënkupton të gjitha produktet e duhanit për përdorim oral, me përjashtim të atyre produkteve që janë për t'u thithur me hundë apo për përtypje, të prodhuara tërësisht ose pjesërisht prej duhanit, në formë pluhuri, grimcash apo të kombinuara së bashku, që pakëtohen në qeska poroze.

26. 'Duhan pa tym' nënkupton një produkt duhani që nuk digjet, duke përfshirë duhanin për përtypje, duhanin për thithje me hundë, duhanin për përdorim oral dhe duhanin me ngrohje.

27. 'Tym' nënkupton grimcat e ngurta ose të lëngëta në ajër dhe gazet e krijuara kur një material digjet së bashku me sasinë e ajrit që përthithet apo përzihet me masën, përfshirë edhe tymin e nxjerrë prej mushkërive gjatë duhanpirjes.

28. 'Djegje' nënkupton një proces kimik oksidimi që ndodh me një shpejtësi aq të madhe sa të prodhojë nxehtësi dhe zakonisht dritë në formë inkandeshente ose flake.

29. 'Produktet e reja të duhanit' nënkuptojnë produktet e duhanit që:

a) nuk bëjnë pjesë në asnjë nga kategoritë e mëposhtme si: cigare, duhan kaush/për t'u dredhur, duhan për nargjile, puro, cigarillo, duhan për përtypje, duhan për thithje me hundë, duhan për përdorim nga goja;

b) vendosen në treg pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

30. 'Cigare elektronike' nënkupton një produkt që mund të përdoret për konsum të avullit që përmban nikotinë me anë të një pjese që vendoset pranë gojës ose çdo përbërës tjetër i atij produkti, duke përfshirë një mbajtëse, një depozitë dhe një pajisje pa mbajtëse ose depozitë. Cigaret elektronike mund të jenë njëpërdorimshme, me rimbushje me anë të një ene për rimbushje ose një depozite, ose mund të rikarikohen me një mbajtëse njëpërdorimshëm.

31. 'Enë rimbushëse' nënkupton një pajisje që mban një lëng me përmbajtje nikotine, e cila mund të përdoret për rimbushje të një cigareje elektronike.

32. 'Duhan me ngrohje' nënkupton një produkt duhani, posaçërisht i krijuar për t'u ngrohur, që përdoret për të çliruar aerosol që përmban nikotinë dhe substanca të tjera, i cili thithet nga përdoruesit nëpërmjet gojës.

33. 'Shije karakteristike' nënkupton një shije apo aromë qartësisht të dallueshme, e ndryshme nga ajo e duhanit si rezultat i përdorimit të një lënde shtesë apo i një kombinimi lëndësh shtesë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: fruta, erëza, barishte, alkool, karamеле, mentol ose vanilje, të cilat janë të kuptueshme para ose gjatë konsumit të produkteve të duhanit.

34. 'Cigarillo' nënkupton një lloj puroje, me peshë jo më të madhe se 3 gram.

35. 'Substancë shtesë' nënkupton një substancë të ndryshme nga duhani, e cila i shtohet një produkti duhani, një njësie pakete ose çdo paketimi të jashtëm.

36. 'Aromatizues' nënkupton një substancë shtesë e cila mundëson aromë dhe/ose shije.

37. "Duhan" nënkupton gjethet natyrore dhe pjesët e tjera të përpunuara ose të papërpunuara të bimëve të duhanit, duke përfshirë duhanin e homogjenizuar dhe të rindërtuar.

38. "Duhan i përtypshëm" nënkupton një produkt duhani pa tym, i destinuar vetëm për qëllime të përtypjes.

39. "Produkte duhani për tymosje" do të thotë produkte duhani të ndryshme nga produktet e duhanit pa tym.

40. "Produkt bimor për tymosje" nënkupton një produkt të bazuar në bimë, barishte ose fruta që nuk përmban duhan dhe që mund të konsumohet nëpërmjet një procesi djegieje.

KREU II

PARALAJMËRIMET E DETYRUARA SHËNDETËSORE NË PRODUKTET E DUHANIT

Neni 4

(shtuar fjalë në paragrafin e parë dhe ndryshuar fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 49/2013, datë 14.2.2013)

Në çdo njësi pakete apo paketimi të produkteve të duhanit duhet të figurojnë mesazhe paralajmëruese në tekst dhe/ose në figurë për dëmet që shkakton në shëndet përdorimi i duhanit. Këto mesazhe duhet të jenë të shkruara në gjuhën shqipe, qartë, dukshëm dhe lexueshëm. Ato duhet të zënë 50 për qind ose më shumë të sipërfaqes së shfaqur, por jo më pak se 30 për qind të faqes kryesore.

Forma dhe përmbajtja e mesazheve përcaktohen nga KNMSHPD-ja dhe riformulohen periodikisht.

Neni 5

(shtuar pikat 4, 5 dhe 6 me ligjin nr. 56/2019, datë 18.7.2019)

1. Në paketat dhe pakot, që përmbajnë produkte duhani, duhet të figurojnë, gjithashtu, të shkruara në gjuhën shqipe:

- a) emri i produktit;
- b) emri, adresa e prodhuesit dhe e mbajtësit të licencës;
- c) numri i pjesëve të produktit të duhanit në pako apo paketë;
- ç) sasia e nikotinës në tym;
- d) sasia e katranit në tym;
- dh) sasia e monoksidit të karbonit në tym.

2. Nëse produkti nuk është paketuar nga prodhuesi i tij, paketa duhet të përmbajë edhe emrin e paketuesit. Të dhënat e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni duhet të zënë 10 për qind të sipërfaqes së jashtme të paketës dhe vendosen në faqet anësore të saj.

3. Ndalohen prodhimi në vend, importimi dhe tregtimi i produkteve të duhanit, që përmbajnë më shumë se:

- 10 mg katran për cigare;
- 1 mg nikotinë për cigare;
- 10 mg monoksid karboni.

Testet për sasinë e katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit duhet të kryhen në laboratorë të akredituar nga autoritetet përkatëse, duke u bazuar në standardet ISO.

4. Çdo njësi paketimi e cigareve elektronike dhe paketim i rimbushjeve të lëngut të nikotinës duhet të përmbajë një fletë informuese në gjuhën shqipe, ku të përfshihet informacion rreth: instruksioneve të përdorimit dhe magazinimit të produktit, duke përfshirë dhe një referencë që ky produkt nuk rekomandohet të përdoret nga të rinjtë dhe nga joduhanpirësit; kundërlindikacionet e përdorimit; paralajmërimet për grupet e veçanta të riskut, paralajmërimet për efektet anësore; shkallën e varësisë dhe toksicitetit; detajet e kontaktit të prodhuesit ose importuesit.

5. Lëngu me përmbajtje nikotine vendoset në treg vetëm kur është në mbajtëse të dedikuara për rimbushje, me volum jo më shumë se 10 ml ose në formën e cigareve elektronike njëpërdorimshme, me volum jo më shumë se 2 ml.

6. Nuk lejohet vendosja në treg e lëngut që përmban më shumë se 20 mg/ml nikotinë.

Neni 6

Ndalohet shënimi mbi paketa ose pakot e produkteve të duhanit i shprehjeve, si: “me përmbajtje të ulët katrani”, “e lehtë”, “ultra e lehtë”, “e butë” apo terma, shenja, foto, vizatime dhe elemente të tjera të ngjashme, që kanë qëllim të krijojnë përshtypje të gabuar se një produkt duhani është më pak i dëmshëm për shëndetin se produktet e tjera.

Neni 7

Ministria e Shëndetësisë ka për detyrë të njoftojë publikun për nivelet e katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit në prodhimin e produkteve të duhanit, për ndikimin e tyre në shëndet,

si dhe për çdo efekt që shkakton ose mendohet se mund të shkaktojë varësi të përdoruesit ndaj produktit të duhanit.

Neni 8

(ndryshuar me ligjin nr. 56/2019, datë 18.7.2019)

1. Prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit, përfshirë cigaret elektronike dhe duhanin me ngrohje, janë të detyruar të njoftojnë Ministrinë përgjegjëse për Shëndetësinë për produktet e duhanit që qarkullojnë në tregun vendas, si dhe për çdo rast kur prej tyre hidhet në treg një produkt i ri duhani. Ky lajmërim duhet dorëzuar në formë elektronike, jo më vonë se 30 ditë para hedhjes në treg të produktit. Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) informacioni kontakti të prodhuesit ose importuesit në Shqipëri;
- b) një përshkrim të detajuar të produktit;
- c) instruksionet e lidhura me përdorimin e tij;
- d) një listë të të gjithë përbërësve të përdorur në fabrikimin e produktit të duhanit dhe sasitë e tyre, arsyen apo qëllimin e përdorimit të këtyre përbërësve, si dhe të përcaktojnë funksionimin dhe kategorinë e përbërësve. Kjo listë duhet të shoqërohet me të dhëna toksikologjike, të disponueshme prej fabrikuesit apo importuesit, për këta përbërës, në formë të djegur apo të padjegur, duke u shprehur në mënyrë të veçantë për efektet e tyre mbi shëndetin dhe duke vlerësuar çdo efekt që shkakton ose mendohet se mund të shkaktojë varësi të përdoruesit ndaj produktit të duhanit.
- e) materialet e disponueshme të kërkimeve shkencore, rrezikun e varësisë dhe tërheqjen e produktit.

KREU III

MASAT KUFIZUESE PËR PËRDORIMIN E PRODUKTEVE TË DUHANIT

Neni 9

(ndryshuar me ligjin nr. 92/2024, datë 26.7.2024)

1. Ndalohet shitja ose furnizimi për qëllime tregtimi i produkteve të duhanit, i cigareve, cigareve elektronike, shishave/nargjileve dhe i të gjitha produkteve të parashikuara në nenin 3, “Përkufizime”, të këtij ligji, personave nën moshën 18 vjeç.

2. Ndalohet ofrimi falas ose shitja e tyre me ofertë i produkteve të duhanit, cigareve, cigareve elektronike, shishave/nargjileve dhe i të gjitha produkteve të parashikuara në nenin 3, “Përkufizime”, të këtij ligji, personave nën moshën 18 vjeç.

3. Të gjitha pikat e shitjes duhet të pajisen me tabelë të dukshme dhe të lexueshme, ku të shkruhet: “Ndalohet shitja e produkteve të duhanit, cigareve elektronike, shishave/nargjileve personave nën 18 vjeç”.

Neni 9/1

Duhani për përdorim oral

(shtuar me ligjin nr. 92/2024, datë 26.7.2024)

Ndalohet vendosja në treg e duhanit për përdorim oral.

Neni 10

(ndryshuar me ligjin nr. 92/2024, datë 26.7.2024)

Ndalohet shitja e produkteve të duhanit, cigareve elektronike, shishave/nargjileve dhe e të gjitha produkteve të parashikuara në nenin 3, “Përkufizime”, të këtij ligji:

- a) në institucionet shëndetësore;

- b) në institucionet arsimore;
- c) në institucionet sportive;
- ç) në makinat shitëse automatike;
- d) me anë të vetëshërbimit;
- dh) në rrugë nga shitësit ambulantë;
- e) nëpërmjet shërbimit postar.

Neni 11

(shtuar paragrafë pas paragrafit të parë me ligjin nr. 56/2019, datë 18.7.2019)

Ndalohet shitja me pakicë e produkteve të duhanit të papaketuara ose me paketim të dëmtuar.

Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit me shije karakteristike. Nuk ndalohet përdorimi i substancave shtesë, të cilat janë të domosdoshme për prodhimin e produkteve të duhanit, siç është përdorimi i sheqernave që zëvendësojnë sheqerin e humbur gjatë procesit të përpunimit të duhanit, me kusht që këto substanca shtesë nuk shkaktojnë shije karakteristike dhe nuk rrisin në një nivel domethënës dhe të matshëm shkallën e varësisë, toksicitetit ose karakteristikave karcinogjene, mutagjene dhe toksicitetit për riprodhim të produktit të duhanit.

Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë përcakton nëse një produkt duhani konsiderohet produkt duhani me shije karakteristike. Procedurat për mënyrën e përcaktimit të produkteve të duhanit me shije karakteristike bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit që përmbajnë aromatizues në secilin prej komponentëve, si filtra, letra, paketime, kapsula apo çdo modifikim teknik që lejon modifikimin e aromës ose shijes së produktit të duhanit ose intensitetin e tymit. Filtrat, letrat dhe kapsulat nuk duhet të përmbajnë duhan apo nikotinë.

Një njësi pakete cigare duhet të përmbajë të paktën 20 cigare. Një njësi pakete duhan për dredhje duhet të përmbajë jo më pak se 30 gram neto produkt duhani.

Neni 12

Ndalohet ofrimi falas i produkteve të duhanit nga subjektet që i prodhojnë, i importojnë ose i tregtojnë ato.

KREU IV

REKLAMA, PROMOVIMI DHE SPONSORIZIMI

Neni 13

(ndryshuar me ligjin nr. 92/2024, datë 26.7.2024)

1. Për duhanin, produktet e duhanit, cigaren elektronike dhe për të gjitha produktet sipas përkufizimeve të këtij ligji ndalohet:

a) reklamimi dhe promovimi nëpërmjet medias së shkruar, transmetimeve televizive e radiofonike dhe shërbimeve të shoqërive të informacionit;

b) çdo lloj forme tjetër reklamimi përfshirë promocionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot/stemat e kompanive ose promocionin nëpërmjet ekspozimit të produkteve që imitojnë paketimin e jashtëm; si dhe

c) për qëllime reklamimi apo promovimi, botimi i fotografive, vizatimeve etj., në të cilat shfaqen persona apo imazhe që krijojnë përshtypje të gabuar te publiku;

ç) çdo aktivitet publik me karakter artistik, muzikor, sportiv, etj., ku reklamohet drejtpërdrejt, në mënyrë të tërthortë apo të fshehtë, me financim publik apo tërësisht privat.

2. Nuk përbëjnë reklamim dhe promovim të produkteve të duhanit, librat teknikë, revistat dhe botimet e tjera profesionale për duhanin.

Neni 14

(ndryshuar me ligjin nr. 92/2024, datë 26.7.2024)

Për duhanin, produktet e duhanit, cigaren elektronike dhe për të gjitha produktet sipas përkufizimeve të këtij ligji ndalohet:

Sponsorizimi i medias së shkruar, i programeve radiofonike, televizive, i shërbimeve të shoqërive të informacionit dhe i çdo veprimtarie tjetër që ka qëllim promovimin apo reklamimin e drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të tyre, nga shoqëri që kanë për objekt të veprimtarisë prodhimin, importimin apo tregtimin e tyre, me përjashtim të sponsorizimit për qëllime të tjera të mira, përfshirë investime, që nuk përbëjnë reklamimin e produkteve të duhanit.

Neni 14/1

(shtuar me ligjin nr. 76/2014, datë 10.7.2014)

1. Radiotelevizioni Publik Shqiptar transmeton çdo muaj programe edukative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në përputhje me ligjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Këto programe edukative kanë një kohëzgjatje në total prej 90 minutash dhe transmetohen nga ora 8⁰⁰ deri në orën 22⁰⁰. Një prej këtyre programeve, me kohëzgjatje prej 30 minutash transmetohet detyrimisht nga ora 17⁰⁰ deri në orën 22⁰⁰.

2. Në faqet zyrtare të internetit të institucioneve publike publikohen, në vend të dukshëm, mesazhe informuese për ndikimet e duhanpirjes në shëndet dhe rreziqet nga produktet e duhanit.

KREU V

MBROJTJA PREJ EKSPOZIMIT TË PAVULLNETSHËM NDAJ TYMIT TË DUHANIT

Neni 15

(ndryshuar shkronja "dh" me ligjin nr. 49/2013, datë 14.2.2013 dhe ndryshuar me ligjin nr. 76/2014, datë 10.7.2014)

1. Ndalohet pirja e duhanit në:

- a) mjediset e punës;
- b) institucionet shëndetësore, me përjashtim të institucioneve të shëndetit mendor (vetëm për pacientët);
- c) institucionet arsimore, përfshirë dhe çerdhet;
- ç) mjetet e transportit publik, përfshirë taksitë;
- d) mjediset e mbyllura tregtare, bare, restorante, diskoteka dhe klubet e natës;
- dh) mjediset e mbyllura kulturore e sportive;
- e) mjediset e përbashkëta, në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme;
- ë) mjediset e tjera publike të mbyllura.

2. Në mjediset/institucionet e mësipërme nxirret një rregullore e brendshme, ku theksohet ndalimi i pirjes së duhanit në këto mjedise dhe përcaktohet qartë personi, i cili do të jetë përgjegjës për rastet e shkeljes.

Neni 16

(shtuar një fjali në fund të nenit me ligjin nr. 49/2013, datë 14.2.2013 dhe ndryshuar me ligjin nr. 76/2014,

datë 10.7.2014)

Pronari ose administratori i mjediseve të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji apo personi i caktuar prej tyre është përgjegjës për vendosjen në një vend të dukshëm të listës së trupave inspektuese për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, të shenjave të dukshme, që tregojnë se pirja e duhanit në këto mjedise është e ndaluar, si dhe të heqë e të mos lejojë vendosjen e tavllave të duhanit në këto mjedise. Forma dhe teksti i shenjave paralajmëruese përcaktohen nga KNMSHPD-ja.

KREU VI ORGANIZIMI I STRUKTURAVE TË MBROJTJES SË SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT

Neni 17

Pranë Ministrisë së Shëndetësisë ngrihet Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD). Kryetar i KNMSHPD-së është Ministri i Shëndetësisë.

Mënyra e organizimit, e funksionimit, e përbërjes, si dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të Komitetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

KNMSHPD-ja përgjigjet për:

- a) orientimin e politikave dhe strategjisë për mbrojtjen e shëndetit të publikut nga produktet e duhanit;
- b) rishikimin e akteve në fuqi për mbrojtjen e shëndetit të publikut nga produktet e duhanit dhe propozimin për përmirësimin e ligjit;
- c) propozimin e programeve dhe të projekteve, për të siguruar uljen e përdorimit të produkteve të duhanit dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, monitorimin dhe vlerësimin e këtyre programeve dhe projekteve;
- ç) orientimin e burimeve drejt programeve dhe projekteve, që synojnë uljen e përdorimit të produkteve të duhanit dhe mbrojtjen e shëndetit prej tyre;
- d) sigurimin e bashkëpunimit me institucione qeveritare dhe joqeveritare, brenda dhe jashtë vendit, për politikat e kontrollit të duhanit;
- dh) paraqitjen e raporteve vjetore pranë komisionit parlamentar përkatës.

KREU VII KONTROLLI, MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT DHE KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 19

(ndryshuar emërtime dhe shtuar një paragraf me ligjin nr. 49/2013, datë 14.2.2013 dhe ndryshuar me ligjin nr. 76/2014, datë 10.7.2014, ndryshuar emërtime me ligjin nr. 56/2019, datë 18.7.2019)

1. Institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të këtij ligji janë:
 - a) struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, organet e administratës doganore dhe organet tatimore, për shkeljen e neneve 4, 5 dhe 6. Në rastet kur këto institucione zhvillojnë kontrolle të përbashkëta, ato duhet të bashkërendojnë punën për këtë qëllim;
 - b) organet tatimore, për shkeljen e nenit 9;
 - c) struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, për shkeljen e shkronjës “a”, të nenit 10;

- c) inspektorati që mbulon fushën e arsimit, për shkeljen e shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 10;
- d) organet tatimore, për shkeljen e shkronjave “ç”, “d” e “dh”, të nenit 10;
- dh) struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe organet tatimore, për shkeljen e neneve 11, 12, 13 dhe 14;
- e) inspektorati që mbulon fushën e punës, fushën e shëndetit dhe inspektorati i sigurisë ndaj zjarrit, për shkeljen e shkronjës “a”, të nenit 15;
- ë) struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, për shkeljen e shkronjës “b”, të nenit 15;
- f) inspektorati që mbulon fushën e arsimit dhe ai që mbulon fushën e shëndetit, për shkeljen e shkronjës “c”, të nenit 15;
- g) Policia e Shtetit dhe policia bashkiake/komunare, për shkeljen e shkronjës “ç”, të nenit 15;
- gj) inspektorati që mbulon fushën e punës, inspektorati që mbulon fushën e shëndetit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për shkeljen e shkronjës “d”, të nenit 15;
- h) struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe inspektori i policisë së zonës, për shkeljen e shkronjës “dh”, të nenit 15;
- i) policia bashkiake/komunare dhe inspektori i policisë së zonës, për shkeljen e shkronjës “e”, të nenit 15;
- j) struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, për shkeljen e shkronjës “ë”, të nenit 15.

2. Trupat inspektuese, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, që burojnë nga ky ligj, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Inspektorati Qendror bashkërendon veprimtarinë inspektuese të trupave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni. Ngarkohet struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit për monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe mbledhjen e informacionit nga trupat e tjerë inspektues në zbatim të tij.

Neni 20

(ndryshuar shkronja “e” dhe “d”, shtuar një paragraf pas shkronjës “ë” dhe ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 49/2013, datë 14.2.2013 dhe ndryshuar me ligjin nr. 76/2014, datë 10.7.2014, shtuar germa a/a dhe pika 1/1 me ligjin nr. 56/2019, datë 18.7.2019; ndryshuar shkronja b) e pikës 1 me ligjin nr. 92/2024, datë 26.7.2024)

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) shkelja e neneve 4 e 5, pika 1, shkronjat “ç”, “d” e “dh” dhe pika 3, si dhe nenit 6 dënohet me konfiskim, asgjësim të mallit dhe 5 000 000 (pesë milionë) lekë gjobë, sipas rastit, për importuesin e produktit apo prodhuesin vendas;

a/a. Shkelja e nenit 8, dënohet me 500 000 lekë gjobë për prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit.

b) shkelja e nenit 9 dënohet me:

i. konfiskim të produkteve të duhanit, cigareve, cigareve elektronike dhe të të gjitha produkteve të parashikuara në nenin 3, “Përkufizime”, të këtij ligji dhe gjobë 200.000 lekë për subjektin shitës me shumicë apo pakicë, apo subjektit që e ofron falas sipas kushteve të nenit 9/1 dhe nenit 10;

ii. 500.000 lekë gjobë kur kjo shkelje përsëritet nga subjekti sipas kushteve të nenit 9 dhe nenit 10;

iii. dyfishim të gjobës së parashikuar në shkronjën “i”, në rastin e shitjes ose ofrimit të cigareve elektronike nën moshën 15 vjeç.

c) shkelja e nenit 10 dënohet me konfiskim të produkteve të duhanit dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë, sipas rastit, për subjektin shitës me pakicë ose subjektin e tatueshëm të veprimtarisë së

parashikuar;

c) shkelja e nenit 11 dënohet me konfiskim të produkteve të duhanit dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë gjobë për shitësin me pakicë;

d) shkelja e nenit 12 dënohet me konfiskim të produkteve të duhanit dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë, sipas rastit, për subjektin prodhues, importues apo tregtues, që ka kryer shkeljen;

dh) shkelja e nenit 13, paragrafi i parë dhe i dytë, dënohet me 3 000 000 (tre milionë) lekë gjobë, për subjektin e tatueshëm të veprimtarisë së reklamës, medias së shkruar, transmetimit televiziv, radiofonik apo të shërbimit të shoqërisë së informacionit;

e) shkelja e nenit 14 dënohet me 3 000 000 (tre milionë) lekë gjobë për subjektin prodhues, importues apo tregtues të produkteve të duhanit, që ka kryer shkeljen;

ë) shkelja e nenit 15 dënohet me gjobë si më poshtë:

i) 300 000 (treqind mijë) lekë, subjekti i tatueshëm;

ii) 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, personi përgjegjës në institucionet publike;

iii) 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, administratori në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme;

iv) 5 000 lekë (pesë mijë) lekë, duhanpirësi;

f) shkelja e nenit 16 dënohet me gjobë si më poshtë:

i) 300 000 (treqind mijë) lekë, subjekti i tatueshëm;

ii) 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, administratori apo personi i caktuar përgjegjës.

1/1. Për shkelje të nenit 15 dy herë brenda një periudhe 3-mujore, subjekti i tatueshëm dënohet me gjobë sa dyfishi i gjobës së vendosur në nënndarjen “i”, të shkronjës “ë”, të këtij neni.

Nëse subjekti i tatueshëm i penalizuar për herë të dytë gjendet përsëri në shkelje të nenit 15, brenda një afati kohor 1-vjeçar, atëherë ndaj tij vendoset gjobë në vlerën e gjashtëfishit të gjobës së vendosur në nënndarjen “i”, të shkronjës “ë”, të këtij neni, dhe pezullim i aktivitetit deri në shlyerjen e masave të gjobës.

2. Masa e konfiskimit dhe e asgjësimit janë dënime kryesore, ndërsa masa e gjobës është dënim kryesor, kur parashikohet si dënim më vete dhe dënim plotësues, kur jepet njëkohësisht me masën e konfiskimit ose asgjësimit.

3. Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektuese, të përcaktuara në këtë ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin, ndërsa ankimi ndaj organeve tatimore, doganore, Policisë së Shtetit, policisë bashkiake ose të komunës, sipas legjislacionit në fuqi. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

4. Të ardhurat nga gjokat e vendosura, sipas këtij neni, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 21

Paragrafi i tretë i nenit 19/a dhe paragrafi i tretë i nenit 19/b të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar, shfuqizohen.

Neni 22

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 17 e 19, të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare

(vendosur me ligjin nr. 49/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa zbatimi i nenit 6 të këtij ligji i shtrin efektet nga data 1 janar 2009.

**Shpallur me dekretin nr.5122, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**